

RAPORT VJETOR

**MBI VEPRIMTARINË
E QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË
PËR VITIN KALENDARIK 2024**



Hyrje.....	3
Arritjet kryesore gjatë vitit 2024	4
Të dhëna statistikore mbi veprimtarinë e QKK-së, krahasuar me vitet 2021, 2022, 2023	7
Objektivat strategjike, zbatimi dhe monitorimi i tyre, strategjitë e reja, strategjitë ndërsektorale	11
Procesi i Integritetit Evropian dhe bashkëpunimi me të tretët, bashkëpunimi me institucionet e huaja	12
Marrëveshjet e bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit	13
Nismat ligjvënëse dhe aktet nënligjore.....	14
Tregues të veprimtarive monitoruese, rezultatet	15
Kontratat e prokurimit të nënshkruara dhe të realizuara	15
Forcimi i kapaciteteve administrative	16
Realizimi i buxhetit për vitin 2024.....	16

HYRJE

Qendra Kombëtare e Kinematografisë, është një institucion qendror në varësi të Ministrisë së Kulturës për bashkërendimin e punës, mbështetjen financiare, nxitjen e veprimtarisë kinematografike në Republikën e Shqipërisë dhe për përfaqësimin e kinematografisë shqiptare në botë, i cili është themeluar nëpërmjet Ligjit me № 8096, të datës 21 Maj 1996, të emërtuar «Për Kinematografinë», të amenduar, si dhe funksionon në bazë të kësaj të fundit, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me №602, të datës 21 Gusht 2003, të emërtuar «Për miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare Kinematografike», si dhe të tri rregulloreve, të cilat, gëzojnë statusin e akteve nënligjore me fuqi detyruese të përgjithshme, në sferën e kinematografisë dhe audio-vizualit.

Ajo u themelua, më 8 prill 1997, nga Këshilli i Ministrave. Fondi i saj është publik, dhe me zë më vete në buxhetin e shtetit. Pjesa e mbetur në fund të vitit mbartet në vitin pasardhës. Përdorimi i fondit buxhetor për financimin e prodhimit të projekteve kinematografike përjashtohet nga procedurat e ligjit përkatës të prokurimit publik.

Kompetencat kryesore të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë janë:

1. Planifikimi i shpërndarjes së fondit buxhetor për gjinitë e filmit (artistik, dokumentar e të animuar).
2. Shpërndarja e fondit për projektet që përmbushin kërkesat e rregullores për prodhimin e shpërndarjen e filmit dhe që kanë vlera cilësore dhe interes kulturor kombëtar. Gjithashtu, raporton për realizimin e projekteve dhe fondeve të miratuara.
3. Miraton projektet për realizimin e veprave filmike të producentëve shqiptarë e të huaj dhe i financon ato.
4. Përcakton fondet për festivale e javë filmi kombëtare e ndërkombëtare.
5. Propozon ndryshime dhe përmirësime në ligje, vendime, urdhra e urdhëresa të fushës dhe, veçanërisht, për masat organizative, teknike, ligjore dhe financiare, për një funksionim më të mirë të sistemit ligjor kombëtar të filmit, të cilat, pasi shqyrtohen nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave nëpërmjet saj.
6. Organizon dhe mbështet financiarisht kualifikimin, specializimin dhe përgatitjen e kineastëve të rinj, si dhe botimet e ndryshme të veprimtarisë kinematografike.
7. Regjistron të gjithë personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e prodhimit dhe të shpërndarjes së filmave, sipas procedurave të përcaktuara në rregullore, si dhe pajis me certifikatë për ushtrimin e këtyre veprimtarive të gjithë aplikantët, që plotësojnë kushtet e nevojshme, të përcaktuara në rregullore.
8. Regjistron të gjithë personat fizikë e juridikë që zotërojnë sallat ose mjedise të tjera për shfaqjen e veprave filmike, sipas rregullores së shpërndarjes dhe shfaqjes së veprave filmike në territorin e Republikës së Shqipërisë.
9. Regjistron filmat e realizuar ose të importuar që do të shfaqen në territorin e Shqipërisë.
10. Kontrollon zbatimin e standarteve teknike të aparaturave që funksionojnë në Shqipëri për prodhimin dhe shpërndarjen e veprave filmike.
11. Organizon kualifikimin, specializimin dhe përgatitjen e kineastëve të rinj.
12. Informon producentët për mundësitë e saj financiare, për ndryshimet në këshillat e saj miratues, për ndryshimet e akteve ligjore e nënligjore dhe për pjesëmarrjen në festivale e javë të filmit kombëtar e ndërkombëtar.

13. Shqyrton, nga ana artistike, projektet e paraqitura nga relatorët e caktuar në këshillin e projekteve.

14. Analizon dokumentacionin tekniko-ekonomik të projekteve të paraqitura, duke zbatuar normativat e miratuara prej saj.

15. Mbështet financiarisht, me një fond të veçantë buxhetor, projektet e shpërndarjes së veprave filmike shqiptare, brenda dhe jashtë vendit.

ARRITJET KRYESORE GJATË VITIT 2024

(i) Më 1 shtator 2024, pas përpjekjeve serioze dhe këmbëngulëse, prej Kryetarit të QKK-së, Z. Eol Çashku, me mbështetjen e CNC (Centre National du Cinéma et de l'Image Animée) franceze dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, u arrit që Qendra Kombëtare e Kinematografisë të pranohej si anëtare pranë EFAD (*European Film Agency Directors*). Vendimi u mor njëzëri, në mbledhjen e komitetit drejtues të EFAD-it gjatë Festivalit të Filmit në Venecia. Kjo organizatë përfaqëson organizmat kombëtarë të sektorit të filmit dhe audio-vizualit nga vendet evropiane, të cilët, janë edhe anëtarë të saj. President i EFAD-it, Chris Marcich deklaroi se: «Kemi kënaqësinë të mirëpresim Shqipërinë në familjen tonë evropiane. Presim me padurim një bashkëpunim të frytshëm». Kryetari i QKK-së, theksoi: «Unë besoj se, ribashkimi i kontinentit tonë kalon para së gjithash nga kultura dhe dija. Për këtë arsye EFAD (DAEF) përbën një instrument të shkëlqyer për të ndarë njohuritë dhe praktikat më të mira, me qëllim nxitjen e mbështetjes dhe përkrahjes për krijimtarinë kinematografike evropiane.» (burimi: <https://www.europeanfilmagencies.eu/news/the-albanian-national-cinematography-center-becomes-the-38th-efad-member>)



(ii) U arrit të përfundohej procesi i përditësimit, nëpërmjet depozitimit të dokumentacionit ligjor, nga ana e shoqatave të kineastëve pranë Qendrës Kombëtare të Kinematografisë. Diçka e tillë nuk ishte realizuar ndër vite, për shkak të moszbatimit të

përpiktë të legjislacionit në fuqi. Ndërkaq, mungesa e vullnetit institucional për të korrigjuar mangësitë e theksuara, të cilat, jo vetëm vëreheshin qartë, por edhe janë lejuar me vetëdije, me synimin për të lënë boshllëqe në përzgjedhjen e projekteve kinematografike prej Këshillave Miratues të Projekteve.

(iii) Realizimi me sukses i procesit të ngritjes të Këshillave Miratues të Projekteve (KMP) nga ana e shoqatave të kineastëve, pas më tepër se një viti mungese të këtij organi jetik për veprimtarinë administrative të QKK-së. Këtë herë, në dallim nga dy vjet më parë janë krijuar dy KMP. Njëri për filmat artistikë, dhe tjetri për filmat dokumentarë, vizatimorë dhe të projekteve të ndryshme kinematografike. Këta këshilla vlerësojnë projektet kinematografikë të paraqitur prej producentëve të regjistruar pranë QKK-së, si nga ana artistike, ashtu edhe ajo financiare. Një zgjidhje, për t'ju ardhur në ndihmë krijuesve, ishte edhe krijimi i një Komisioni Përzgjedhës Leximi dhe përzgjedhje të skenarëve, me qëllim filtrimin objektiv të projekteve, përpara se t'i paraqiten KMP-ve. Pas konstatimit të disa problemeve në funksionimin e Komisionit Përzgjedhës të Leximit, ky i fundit u pezullua me qëllim ndreqjen e problemeve të pasqyruara, deri në miratimin e ndryshimeve në rregulloret e QKK-së në Janar 2025.



(iv) Hartimi i dy rregulloreve të reja, si dhe i kodit të sjelljes dhe etikës, duke u mbështetur thellësisht në përvojën më të mirë të vendeve europiane, dhe veçanërisht asaj franceze. *(Analiza më e hollësishme për këtë, është paraqitur në seksionin «nismat ligjvënëse dhe aktet nënligjore»)*


(v) Ndërmarrja me këmbëngulje e nismës për të zbatuar, për herë të parë, pikat 7, 8 dhe 9, të nenit 4, të ligjit me №8096, datë 21.03.1996, «Për Kinematografinë», ndryshuar, qysh prej themelimit të QKK-së më 1997-ën, me synimin e regjistrimit të ligjshëm, nëpërmjet shërbimit në E-Albania, i të gjithë personave fizikë a juridikë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e shpërndarjes së filmave. Mandej, u arrit që distributorët/difuzorët të regjistrojnë ligjërisht, nëpërmjet E-Albania-s, të gjithë filmat e realizuar nga produksionet shqiptarë përpara se ata të shfaqen në kinema apo televizion. *(Analiza më e hollësishme për këtë, është paraqitur në seksionin «nismat ligjvënëse dhe aktet nënligjore»)*

(vi) Qysh prej krijimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, u realizuan me këmbëngulje përpjekjet më serioze të bëra ndonjëherë, për të kërkuar zbatimin e gjysmës së dytë, të fjalisë së parë, të nenit 5, të ligjit me №8096, datë 21.03.1996, «Për Kinematografinë», ndryshuar, prej Ministrisë së Financave, e cila, nga ana tjetër, me këmbëngulje ka refuzuar, përgjatë gjithë këtyre viteve respektimin e një dispozite ligjore në fuqi. Kjo kërkesë legjitime e bërë nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, përfaqësuar nga Kryetari i saj Z. Çashku, mbështetet, jo vetëm në atë që, në gjuhën popullore njihet si diçka e shkruar «e zeza mbi të bardhë», por edhe në rekomandimet e bëra prej Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe Auditit të ish-Ministrisë së Kulturës, lidhur me zbatimin e dispozitës në fjalë. Në lidhje me këtë, Kryetari i QKK-së, Z. Çashku, ka realizuar korrespondenca të shumta me shkrim me Ministrinë e Financave, është takuar me përfaqësuesit më të lartë të administratës së saj për të kërkuar përfundimisht zbatimin e kësaj dispozite, si dhe është dëgjuar në komisionin parlamentar, i cili, mbulon fushën e kulturës dhe të arteve, lidhur me këtë shqetësim, ku një organ ekzekutiv (*Ministria e Financave*) refuzon haptazi dhe me këmbëngulje zbatimin e një dispozite të vendosur nga një organ ligjvënës (*Kuvendi*). Natyrisht, përpjekjet lidhur me zbatimin e plotë të kësaj dispozite nuk do të rreshtin përgjatë vitit 2025.



TË DHËNA STATISTIKORE MBI VEPRIMTARINË E QKK-SË, KRAHASUAR ME VITET 2021, 2022, 2023

(i) Përgjatë vitit 2024, pas proceseve të vlerësimit nga ana e Këshillave Miratues të Projekteve, fituan të drejtën për financim 34 projekte nga 52 të paraqitura për konkurrim.



	sasia	shuma e përgjithshme e financimit
Filma artistikë me metrazh të shkurtër	5 projekte	10.500.000 lekë
Projekte në postproduksion &/e distribucion	2 projekte	6.500.000 lekë
Filma dokumentarë	6 projekte	8.652.600 lekë
Filma të animuar	1 projekt	3.000.000 lekë
Promovimi i kinematografisë shqiptare brenda e jashtë	4 projekte	4.676.000 lekë
Filma me metrazh të gjatë koproduksione në pakicë	6 projekte	30.857.504 lekë
Filma me metrazh të gjatë	2 projekte	43.000.000 lekë
Festivale filmi	8 projekte	14.000.000 lekë
Shuma	34 projekte	121.186.104 lekë

(ii) Kanë përfunduar projektet filmike dhe janë realizuar premierat për publikun, si më poshtë:

(a) Filma artistikë me metrazh të gjatë:

- «Pikë Uji», skenari Robert Budina, Doruntina Basha, Ajola Daja, regjia Robert Budina;
- «Misioni», skenari dhe regjia Andi Deliana;

(b) Filma artistikë me metrazh të gjatë, vepër e parë:

- «Mira», skenari dhe regjia Genc Përmeti;

(c) Filma artistikë me metrazh të gjatë, koproduksion në pakicë (minority coproduction):

- «Ajo që mbetet», shtëpia kinematografike Papadimitri Film Production;

(ç) Filma artistikë independent, me metrazh të gjatë:

- «Emili», regjisore Ajola Daja, shtëpia kinematografike Papadimitri Film Production;

(d) Filma artistikë me metrazh të shkurtër:

- «Polic i mirë, polic i keq», skenari dhe regjia Gledis Bica;
- «Furacaku», skenari dhe regjia Renis Hyka;
- «Një histori e patreguar», skenari Anxhela Çikopano, regjia Sara Hoxhaj;
- «Pluhur i zhuritur/Baltë», skenari, regjia Evi Gjoni;
- «I huaji», skenari Irvin Muça, regjia Ornela Karaj;
- «Kampion», skenari Genc Përmeti, regjia Ermir Keta;

(dh) Filma të animuar:

- «Fani në kërkim të dritës», skenari Roven Rrozhani, regjia Artur Dauti;

(iii) Festivale ndërkombëtarë brenda vendit gjatë vitit 2024:

- «Anifest 2024», zhvilluar në qytetet Shkodër dhe Gjirokastrë;
- «DEA Open Air International Film Festival», zhvilluar në qytetet Tiranë dhe Sarandë;
- «Dropulli International Film Festival», zhvilluar në qytetin e Gjirokastrës;
- «Festivali Ballkanik i Filmit dhe Kulinarisë», zhvilluar në qytetin e Pogradecit;
- «KO:SH Film Fest 2024», zhvilluar në qytetin e Korçës;
- «Open Cinema 2024», zhvilluar në disa qytete të Shqipërisë;
- «Tirana International Film Festival 2024», zhvilluar në kryeqytet, Tiranë;
- «48 Hour Film Project», zhvilluar në kryeqytet, Tiranë;

(iv) Projekte filmike të xhiruara gjatë vitit 2024:

(a) Filma artistikë me metrazh të gjatë:

- Filmi «Hatixhja dhe Shabani», me regji nga Visar Morina, koproduksion në pakicë, shtëpia kinematografike shqiptare «On Film Production»;
- Filmi «Ajo që mbetet», me regji nga Konstadin Bonev, koproduksion në pakicë, shtëpia kinematografike «Papadimitri Film Production»;
- Filmi «Pasojat e Lirisë», me regji të Lorin Terezi, shtëpia kinematografike «Tunnel Film».

(b) Filma të shkurtër:

- Filmi «Furacaku», regjia dhe skenari Renis Hyka, prodhim i shtëpisë kinematografike «Bunker Film+»;
- Filmi «Një histori e patreguar», me skenar Anxhela Çikopano dhe regji Sara Hoxhaj, prodhim i shtëpisë kinematografike «Action Production»

- Filmi «Polic i mirë, polic i keq», me skenar dhe regji Gledis Bica, prodhim i shtëpisë kinematografike «d'Art Production».

(v) Përfaqësim në festivale filmi dhe aktivitete të tjera të rëndësishme ndërkombëtare dhe vlerësimet me çmime:

(a) Filmi artistik me metrazh të gjatë «Pikë Uji», regjia Robert Budina, producente Sabina Kodra, mban premierën ndërkombëtare në Festivalin Ndërkombëtar të filmit të Varshavës. Ky film u përzgjedh si përfaqësues i Shqipërisë në çmimet Oscars 2025;

(b) Filmi Dokumentar «Another Day» / «Një tjetër ditë», regjia Eneos Çarka; fiton çmimin «Balkan Dox Award» në Dokufest, Prizren, Kosovë.

(c) Filmi artistik «Yje të së ardhmes», skenari dhe regjia Edmond Topi, fiton çmimin «Filmi më i Mirë Ndërkombëtar» në festivalin e filmit «Castelli Romani» 2024 (CroFFi), Romë, Itali;

(ç) Filmi «Hatixhja dhe Shabani», me regji nga Visar Morina, ndër 31 projekte fitues në skemën e financimit «Co-Production Support» të Eurimages. Aktualisht në xhirime;

(d) Konkurim zyrtar i filmit «Pas errësirës» / «After Dark», i regjisorit Erenik Beqiri fiton çmimin «Region Sud Prize» në Mediterranean Co-production Forum, Marseille;

(dh) Filmi artistik me metrazh të gjatë «Këtu vallëzohet me hijet», regjia Pluton Vasi dhe prodhim i shtëpisë kinematografike «Artfilm», fiton çmimin «Best Production» në International World Film Awards;

(e) Filmi artistik me metrazh të gjatë «Luna Park», regjia Florenc Papas, prodhim i shtëpisë kinematografike On Film Production, përzgjidhet si «Official Selection» në Edicionin e 55^{të} të International Film Festival of India, Goa;

(ë) Pjesëmarrja e producentëve Sabina Kodra & Blerina Hankollari si dhe regjisorëve Enxhi Rista & Gentian Koçi në «Coproductio Workshop France-Balkans» organizuar nga CNC (Centre National du Cinéma et de l'Image Animée);



(f) Pjesëmarrje e QKK-së me një pavion të përbashkët me Qendrën Kinematografike të Kosovës në Marketet e Filmit të Berlinit (Shkurt 2024) dhe të Kanës (Maj 2024);

(g) Pjesëmarrje e QKK-së, së bashku me Qendrën Kinematografike të Kosovës, në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit GoEast, Wiesbaden, Gjermani, në një sesion të veçantë për të dy vendet «Albania and Kosovo in focus».

(vi) Në lidhje me krahasimin e vitit 2024 në raport me vitet 2021, 2022, 2023, po paraqesim të dhënat përkatëse me to:

(a) Projekte kinematografike të financuara në vitin 2023:


- 5 filma artistikë me metrazh të gjatë, kategoria e koproduksionit në pakicë;
- 8 filma artistikë me metrazh të shkurtër;
- 6 festivale dhe Javë Filmi

(b) Projekte kinematografike të financuara në vitin 2022:

- 6 filma artistikë me metrazh të shkurtër (temë diplome të studentëve të UA)
- 4 filma dokumentarë
- 2 filma të animuar
- 7 festivale dhe javë filmi

(c) Projekte kinematografike të financuara në vitin 2021:

- 2 filma artistikë me metrazh të gjatë
- 2 filma artistikë me metrazh të gjatë, vepër e parë
- 6 filma artistikë me metrazh të shkurtër (temë diplome të studentëve të UA)
- 3 projekte të ndryshme kinematografike
- 5 festivale ndërkombëtare filmi



OBJEKTIVAT STRATEGJIKE, ZBATIMI DHE MONITORIMI I TYRE, STRATEGJITË E REJA, STRATEGJITË NDËRSEKTORIALE

(i) Reformimi i plotë dhe i thellë i sektorit duke bashkëpunuar ngushtësisht ekspertë francezë të CNC, ekspertë shqiptarë dhe evropianë të fushës, bazuar në marrëveshjet e nënshkruara me CNC për përmirësimet e domosdoshme në kuadrin ligjor, me qëllim konsolidimin e sektorit, si dhe thithjen e produksioneve të huaja në Shqipëri.

(ii) Riorganizimi i plotë administrativ i QKK, duke përfshirë organikën e saj, si dhe mënyrën e rekrutimit, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe praktikën më të mira evropiane. Kjo do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Administratës Publike dhe Antikorrupsionit.

(iii) Themelimi i sistemit kinematografik në nivel vendor përmes tri komisioneve rajonale dhe dymbëdhjetë zyrave lokale të filmit (*film commissions*) me detyrat e kategorizimit të aseteve njerëzore dhe logjistike. Koordinimi me pushtetin vendor në të gjithë hapësirën territoriale të Republikës.

(iv) Hartimi i një «Statuti të ri të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë», konform standarteve dhe kuadrit rregullator evropian, në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Nxjerrja e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative lidhur me «*statusin e punonjësit të kinematografisë dhe audiovizualit*». Forcimi i ndërveprimit me strukturat homologe të shqiptarëve të trojeve jashtë Shqipërisë dhe diasporën në botë. Nxitja e përkthimeve të librave mbi filmin e të publikimeve të revistave kinematografike në gjuhën shqipe.

(v) Zbatimi i ligjit për pronësinë intelektuale dhe pjesëve të konsiderueshme të ligjit për kinematografinë që nuk janë zbatuar deri më sot. Vënia në shfrytëzim e filmave të para 1990 vetëm nga distributorë apo difuzorë të licencuar shqiptarë dhe/ose të huaj. Dhënia përparësi e strukturimit të sistemit të shpërblimeve për krijuesit, interpretët dhe ekzekutuesit.

(vi) Rishikimi i licencave dhe i lejeve të produksionit dhe distribucionit. Ndërveprimi me strukturat e tjera të ligjit, riorganizimi i sistemit të grupimeve profesionale vullnetare si dhe përafrimi me praktikën më të mira të vendeve të BE-së. Profilizimi dhe kategorizimi i këtyre grupimeve dhe përfaqësimi i tyre në këshilla e komisione të përkohshëm dhe jofunksionale të QKK-së sipas profileve, me qëllim përgatitjen e vendit në mirëpritjen e produksioneve të huaja.

(vii) Bashkëpunimi dhe ndërveprimi intensiv me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe me Ministrinë e Financave, lidhur me fiskalitetin, taksimin e qarkullimit dhe shfrytëzimit të produkteve kinematografike e audio-vizuale, me qëllim rritjen e fondit të QKK-së. Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me AMA. Krijimi i strukturës Shqiptare dhe implementimi i sistemit ISAN dhe përfshirja e metodave novatore për përafrimin me standardet evropiane të tregut rajonal dhe atij shqipfolës. Implementimi i sistemit ISAN i është propozuar zyrtarisht Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

(viii) Ngritja në një nivel të ri në bashkëpunimin e bashkëveprimit ndërkombëtar. Përfshirja në komisionet e përkohshëm dhe jofunksionale të QKK-së të profesionistëve të huaj në bashkëpunim me strukturat homologe evropiane e përfundimtare.

(ix) Mbështetja, koordinimi dhe riorganizimi i edukimit dhe kualifikimit në zanatet e kinematografisë, shpërndarja e dijes, burimeve njerëzore e infrastrukture, dhe përfshirja e kinematografisë dhe audio-vizualit në tekstet dhe praktikën shkollë bazuar në ekspertizën dhe praktikën më të mira evropiane. Mbështetja e krijimit të programeve të studimit në universitetet publike shqiptare me profil juridik, ekonomik dhe fiskal të kinematografisë. Sa më lart i janë parashtruar zyrtarisht propozime konkrete Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit.

PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI ME TË TRETËT, BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E HUAJA

Tashmë, Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka vendosur «urat e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit», në mënyrë zyrtare, të sigurtë, për të arritur rendimentin e parashikuar në objektivat e këtij 4-vjeçari, të cilat, janë të detajuara në seksionet e tjera të këtij raporti.



Është e rëndësishme për t'u shënuar se, më 1 shtator 2024, pas disa përpjekjeve serioze dhe këmbëngulëse, prej Kryetarit të QKK-së, u arrit që Qendra Kombëtare e Kinematografisë të pranohej si anëtare pranë EFAD (*European Film Agency Directors*). Ajo përfaqëson organizmat kombëtarë të sektorit të filmit dhe audio-vizualit nga vendet evropiane. Në total, antarët e EFAD-it dhe qeveritë e tyre financojnë rreth tri miliardë euro, çdo vit, përmes subvencioneve dhe lehtësimeve tatimore me synimin për të nxitur krijimin, prodhimin, promovimin, shpërndarjen dhe ekspozimin e veprave audio-vizuale dhe kinematografike evropiane. Ky organizëm mundëson një forum me synimin për të diskutuar vazhdimisht rolin e veçantë të organeve të filmit për t'ju përgjigjur mundësive e sfidave që dalin nga zhvillimi i tregut, rregullimit dhe teknologjisë, si dhe ndryshimet në shoqëri dhe kulturë.

Në kuadër të procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European, Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka zgjeruar rrethin e bashkëpunimeve dhe bashkëveprimeve edhe me misione apo organizma të tjerë evropianë. Ato kanë të bëjnë me:

(a) misioni «TALEX» (*Technical Assistance and Information Exchange*);

(b) «Expertise France»;

(c) Qendrës Kinematografike Kombëtare dhe Imazhit të Lëvizshëm, (CNC) të Republikës Franceze;

(ç) bashkëpunimin me vendet e tjera anëtare, në kuadër të SEE (South Eastern European) Cinema Network. Takimi i radhës u mbajt më 5 nëntor 2024 në Selanik me pjesëmarrjen e Kryetarit të QKK-së;

(d) QKK e pranishme, me anë të Kryetarit të saj, për të përfaqësuar Shqipërinë, në mbledhjen e komitetit drejtues të Creative Europe, në Korrik 2024 në Bruksel;

(dh) kontakte të vazhdueshme dhe një takim pune u zhvillua në QKK me Drejtoreshën e QKK-së, Kosovë, Znj. Lindita Zeqiri mbi zgjerimin dhe rritjen e bashkëpunimeve në të gjitha nivelet mes dy qendrave homologe;



(e) në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me QKK-në e Malit të Zi u shfaq filmi artistik «Lejleku», në prani të regjisorit Isa Qosja, dhe dy homologëve të qendrave respektive, Z. Eol Çashku dhe Znj. Alexandra Bozovic.

Më tej, këto bashkëpunime janë detajuar në seksionet e tjera të këtij raporti.

MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT BRENDA DHE JASHTË VENDIT

Në marrëveshje ndërmjet Komisionit European dhe Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, u arrit dakortësia që, gjatë vitit 2025, të realizohet një workshop me misionin TALEX (*Technical Assistance and Information Exchange*). Qëllimi i këtij misioni është që të ndihmojë QKK-në, si përfaqësuese, financuese, dhe rregullatore e sektorit kinematografik e audio-vizual në Republikën e Shqipërisë, me ekspertizën e institucioneve të Bashkimit Evropian lidhur me zbatimin dhe përafrimin e legjislacionit. Misioni TALEX është miratuar nga Brukseli dhe aktualisht pritet përcaktimi i ekspertëve të CNC franceze për

organizimin në gjysmën e parë të vitit 2025 të një konference 3-ditore me fokus në të drejtat e autorit me qëllim informimin e komunitetit. Ekspertizë pritet të ketë dhe për hartimin e statutit të ri të QKK-së, zbatimin e tij, dhe praktikën më të mira që duhet të ndiqen nga vendi i ynë në këtë sektor.

Njëkohësisht, QKK-ja ka arritur të ketë dakordësinë me institucionet shtetërore franceze lidhur me organizimin e një konference bilaterale tri ditore, me fokus te krijimtaria, produksioni, distribucioni dhe difuzioni. Konferenca mendohet të realizohet në gjysmën e parë të 2025, në Tiranë, me mbështetjen financiare të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si dhe me pjesëmarrjen e kineastëve shqiptarë nga rajoni dhe të kolegëve francezë.

Me «*Expertise France*» u arrit dakordësia në parim për iniciimin e procedurave për të dërguar në Shqipëri një ekspert publik të sektorit të kinematografisë dhe audiovizualit, me mision afatgjatë, pranë QKK-së. Misioni i ekspertit do të ndihmojë në zbatimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor të këtij sektori.

NISMAT LIGJVËNËSE DHE AKTET NËNLIGJORE

Në përmbushje të angazhimeve të ndërmarra në platformës së tij, Kryetari i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë i është përkushtuar realizimit të atij vizioni, me synimin, për t'i dhënë vendin e merituar kinematografisë kombëtare në gjirin e kinematografisë evropiane, e më gjerë. Në këtë kuadër, fill pas emërimit të Z. Çashku u ndërmorën një sërë masash me karakter rregullator të akteve nënligjore. Ato kishin të bënin me hartimin e dy rregulloreve të reja të QKK-së, si dhe të Kodit të Sjelljes dhe Etikës, duke u mbështetur thellësisht në parimet, praktikën dhe procedurat e akteve rregullatore të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe Imazhit në Lëvizje, të Francës. Këto akte të reja rregullatore, jo vetëm janë hartuar në përputhje me standartet më të përparuara të vendeve evropiane, por edhe po kontribuojnë në vendosjen në shinat e duhura të sektorit kinematografik dhe audiovizual, për të garantuar projekte cilësorë nga pikëpamja artistike. Gjithashtu, u hartua edhe «Kodi i Sjelljes dhe Etikës», që detajon më tej normat ligjore, me qëllimin për të garantuar integritetin moral e profesional të administratës, në veprimtarinë e saj të përditshme. Deri më sot, që prej krijimit, QKK ka funksionuar vetëm me një rregullore.

Këta akte nënligjorë janë:

(i) «*Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të QKK-së*», miratuar nga Kryetari i QKK-së, me №163 prot., e datës 22 maj 2024;

(ii) «*Rregullore e përgjithshme e mbështetjes financiare dhe lejeve*» (e ndryshuar), miratuar nga Kryetari i QKK-së, me №168 prot., e datës 27 maj 2024;

(iii) «*Kodi i sjelljes dhe etikës në QKK*», №164 prot., e datës 22 maj 2024.

U hartua, dhe u miratua nga Kryetari i QKK-së, urdhri i parë me karakter rregullator dhe me fuqi detyruese, që i përket sferës së veprimtarisë së distributorëve dhe difuzorëve publikë e privatë. Nëpërmjet saj, u arrit për herë të parë të zbatoheshin pikat 7, 8 dhe 9, të nenit 4, të ligjit me №8096, datë 21.03.1996, «Për Kinematografinë», ndryshuar, qysh prej themelimit të QKK-së më 1997-ën. Synimi i saj është regjistrimi i ligjshëm, nëpërmjet

shërbimit në E-Albania, i të gjithë personave fizikë a juridikë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e shpërndarjes së filmave. Mandej, u arrit që distributorët/difuzorët të regjistrojnë ligjërisht, nëpërmjet E-Albania-s, të gjithë filmat e realizuar nga produksionet shqiptarë përpara se ata të shfaqen në kinema apo televizion.

Në këtë kuadër, është e rëndësishme të shënohet se, nevojiten ende akte rregullatorë, duke marrë edhe përvojat më të mira të vendeve evropiane, dhe të cilat janë planifikuar për t'u hartuar e miratuar brenda vitit kalendarik 2025, me qëllim regjistrimin edhe të veprave filmike, të realizuara nga produksione të huaja, por që qarkullojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u shfaqur si nëpër sallat e kinemave, ashtu edhe në ekranet televizive. Mendohet se, këto masa të domosdoshme, gjithashtu edhe shtrënguese, të reflektohen në legjislacionin shqiptar nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave.

Ky akt nënligjor është:

(i) Urdhër me №50, i Kryetarit të QKK-së, i datës 9 tetor 2024, «Për regjistrimin e distributorëve dhe pajisjen me leje qarkullimi të filmave që shfaqen në territorin e Republikës së Shqipërisë».

TREGUES TË VEPRIMTARIVE MONITORUESE, REZULTATET

(shih seksionin «të dhëna statistikore mbi veprimtarinë që kryeni, krahasuar me vitet 2021, 2022, 2023», pasi aty janë të detajuara veprimtaritë e monitorimeve lidhur me realizimin e projekteve kinematografike)

KONTRATAT E PROKURIMIT TË NËNSHKRUARA DHE TË REALIZUARA

Përgjatë vitit 2024, janë realizuar disa prokurime, të cilat, kanë përfunduar me nënshkrimin e disa kontratave.

(i) U realizua fondi limit prej 500.000 lekë të reja, për blerjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Synimi ka qënë zëvendësimi i ordinatorëve të vjetër, të cilët, nuk plotësonin kriteret për të përballuar sisteme shfrytëzimi (O.S.) të rinj. E rrjedhimisht, për të pasur në të programe kompjuterikë të kohës, me versione të reja, me qëllim, pasjen e një performancë më të mirë pune, lidhur me realizimin e detyrave të tyre funksionale të nëpunësve, sigurinë e informacionit elektronik, etj. Gjithashtu, Këshillat Miratues të Projekteve, që funksionojnë pranë QKK-së, janë pajisur me printer me ngjyra të dedikuar, për t'u përdorur prej tyre dhe për nevojat e tyre funksionale, në mbledhjet që realizojnë pranë ambienteve të QKK-së, duke u "izoluar" nga rrjeti kompjuterik i administratës për arsye sigurie, duke qënë se antarët e këtyre këshillave përdorin ordinatorët vetjakë. Njëkohësisht, salla e mbledhjeve të Këshillave Miratues të Projekteve janë pajisur me kamera web, me qëllim për të realizuar edhe «mbledhje hibride», ku disa antarë mund të marrin pjesë online në këto mbledhje, kur arsyet e tyre objektive e pamundësojnë praninë e tyre fizike pranë ambienteve të QKK-së.

(ii) Është shfrytëzuar fondi limit prej 350.000 lekë të reja, me qëllim blerjen e biletave për udhëtim me transport ajror. Blerja e këtyre biletave, nëpërmjet sistemit dinamik të

prokurimit online, ka shërbyer për të mundësuar pjesëmarrjen e Kryetarit të QKK-së, si dhe disa nëpunësve të administratës së QKK-së, në veprimtari ndërkombëtare, të tilla si:

(a) Festivali ndërkombëtar vjetor i Berlinit (*Berlinale 2024*) në Gjermani;

(b) Tregu i filmit (*Marche du film*) pranë festivalit ndërkombëtar të Kanës (*Cannes festival*) 2024 në Francë;

(c) Mbledhja e Komitetit Drejtues të EFAD-it (*European Film Agency Directors association*), gjatë Festivalit të Venecias, ku Qendra Kombëtare e Kinematografisë u pranua për herë të parë si antare;

(d) Asambleja e përgjithëshme e EFAD-it e mbajtur në Bruksel;

(dh) Takime dypalëshe, në interes të përbashkët, pranë Ministrisë franceze për Evropën dhe punët e jashtme, shkollës së filmit Femis si dhe Qendrës Kinematografike Kombëtare dhe Imazhit në Lëvizje, (*CNC*) të Republikës Franceze.

FORCIMI I KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE

Kapacitet administrative të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë kanë pësuar një përmirësim, si sasior, ashtu edhe cilësor, përgjatë vitit 2024. Është përtërirë një e treta e administratës së QKK-së, kryesisht pas daljes në pension të disa nëpunësve të saj. Gjithashtu, janë ripërtërirë pajisjet e teknologjisë së informacionit me synimin për të rritur rendimentin e punës, si të nëpunësve të administratës së QKK-së, ashtu edhe të antarëve të Këshillave Miratues të Projekteve. Në këtë kuadër, të rritjes së rendimentit në punë, QKK-ja është pajisur me ambiente të tjera shtesë, të bollshme, me qëllim realizimin e krejt veprimtarisë së saj në mënyrë të duhur e të përshtatshme. Fondi arkivor i dokumentacionit pranë QKK-së është vendosur në një ambient me vëllime të mëdha përmasore, me ajër të kondicionuar, me rafte metalikë të përshtatshëm për mbajtjen e peshave të dosjeve voluminoze, si dhe të qendrueshëm ndaj lëkundjeve sizmike. Nëpunësit e administratës i realizojnë detyrat e tyre funksionale në zyra të veçanta, të cilat, nuk “vuajnë” më nga fenomeni i dëmshëm i mbipopullimit të tyre. Kjo u arrit falë urdhrit të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit lidhur me zgjerimin e ambienteve, i pari, pas atij të vitit 1999.

Nëpërmjet «*Rregullores së brendshme e organizimit dhe funksionimit të QKK-së*», miratuar nga Kryetari i QKK-së, me №163 prot., e datës 22 maj 2024, janë standardizuar kompetencat, detyrat si dhe të drejtat e nëpunësve të administratës së QKK-së, nëpërmjet përtërítjeve të përshkrimeve të punës. Gjithashtu, e njëjta gjë është realizuar edhe me veprimtarinë e Këshillave Miratues të Projekteve, si dhe të të gjitha komisioneve të tjera, pranë QKK-së, edhe lidhur me zbatimin rigoroz të procedurave administrative, si dhe marrëdhëniet administrative ndërmjet këshillave dhe komisioneve.

REALIZIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2024


Buxheti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, për vitin 2024, është realizuar në total në shumën prej 168.963.497 Lekë, ose në masën 93%. Prej të cilave:

- (i) 151.736.699 Lekë financime për projektet kinematografike;
- (ii) 16.918.293 Lekë për paga, sigurime dhe shpenzime operative;
- (iii) 308,505 Lekë për investime.

Në përllogaritjet e shpenzimeve, të vitit buxhetor 2024, janë përfshirë, gjithashtu, edhe financimet e projekteve të fundit të vitit, të cilat nuk janë kaluar akoma nga thesari.

Të ardhurat dytësore, të cilat, janë realizuar sipas tabelës së mëposhtme arrijnë në vlerën e përgjithshme prej 6.052.250 Lekë.

Llogaria ekonomike	Përshkrimi	Të ardhurat progresive
7111099	Të tjera të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh	461 000
7113002	Shitja e produkteve kulturore dhe artistike	1 718 807
7114200	Shitja e produkteve kulturore dhe artistike 1%	3 626 443
7114200	Të tjera të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh	246 000
	TOTALI	6 052 250



Gjatë vitit 2024 Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka bërë përpjekje të vazhdueshme për zbatimin e Nenit 5 të ligjit për Kinematografinë, duke ju drejtuar me shkresa të përsëritura Ministrisë së Financave, për mbartjen e fondit të QKK në vitet pasardhëse dhe përdorimin e tij për projektet që kanë fituar financim.

Përsa më sipër kjo problematikë i është vënë në dijeni edhe Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe mjetet e Informimit Puublik, gjatë diskutimit për buxhetin afatmesëm 2025-2027.

Shënim: Ky raport u përgatit nga administrata e QKK.